



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:141833
Datë: 27.05.2024
Numri i dokumentit: 05735702

CAP.nr.1632/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren individuale, Halide Reka, në çështjen juridike përmbarimore të kreditores K... K..., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson S... K..., avokat në Prishtinë, kundër debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës-Qendra Klinike Universitare e Kosovës -SHSKUK në Prishtinë, për shkak të përmbarimit të borxhit në emër të shpërblimit jubilar, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditores të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, Cpc.nr.1123/23, të datës 02.10.2023, jashtë seance me datë 27.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditores K... K..., ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, Cpc.nr.1123/23 i datës 02.10.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar Cpc.nr.1123/23 i datës 02.10.2023 e ka refuzuar si të pa bazuar propozimin për lejimin e përmbarimit të kreditores K... K..., i ushtruar në këtë gjykatë me datë 22.06.2023, sipas dokumentit përmbarues - Vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1715/94 të datës 10.02.2020.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor, kreditorja përmes të autorizuarit të saj, ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ta aprovoj ankesën si të bazuar, të prishet vendimi i shkallës së parë dhe të lihet në fuqi propozimi për përmbarim dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Debitori nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e kreditores.

Gjykata e Apelit, përmes gjyqtares individuale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën

Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditores është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditorja me datën 22.06.2023, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit në bazë të titullit ekzekutiv - Vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1715/94 të datës 10.02.2020 si dhe vendimit për korigjimin e gabimit të IP-së të shkallës së parë me nr.01/21-1178 të datës 18.11.2020.

Gjykata Themelore në Prishtinë duke vendosur lidhur me propozimin për përmbartim me aktvendimin e ankimuar Cpc.nr.1123/23 i datës 02.10.2023 e ka refuzuar si të pa bazuar propozimin për lejimin e përmbartimit të kreditores , duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës ka gjetur se propozimi për lejimin e përmbartimit duhet të refuzohet si i pabazuar. Kjo për shkak se dokumenti në bazë të cilit është iniciuar procedura përmbartimore konform nenit 22 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, ashtu siç është plotësuar dhe ndryshuar, tutje referuar si “Ligji për Procedurën Përmbartimore”, edhe pse përbën titull ekzekutiv - dokument përmbartimor, i njëjti nuk është i përshtatshëm për përmbartim. Në lidhje me këtë neni 27, paragrafi 1, i Ligjit për Procedurën Përmbartimore, shprehimisht përcakton se: “dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të janë treguar kreditori, debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.” Mbi këtë bazë, është e qartë se në mënyrë që një dokument përmbartimor të jetë i përshtatshëm për përmbartim, duhet që në mënyrë kumulative të plotësoj të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 27, paragrafin 1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore dhe atë pa asnjë përjashtim. Rrjedhimisht, bazuar në kërkesën ligjore të lartpërmendur, dokumenti përmbartues mbi bazën e të cilit kreditori e ka ushtruar propozimin për lejimin e përmbartimit në rastin konkret është i pa përshtatshëm për përmbartim. Kjo sepse në dispozitivin e vendimit, përkatësisht dokumentit përmbartimor nuk është përcaktuar shuma të cilën debitori i përmbartimit duhet ta përmbushë ndaj kreditorit të përmbartimit por vetëm në mënyrë të përgjithësuar është obliguar punëdhënësi të bëjë pagesën e kompensimit të dy pagave, pa asnjë specifikim të shumave që duhet kompensuar. Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata e shkallës së parë, në rastin konkret, ka konstatuar se dokumenti përmbartimor me të cilin është iniciuar procedura përmbartimore në këtë çështje juridike, konkretisht Vendimi i Inspektoratit të Punës, me të cilin është obliguar debitori që në afat prej tetë (8) ditësh, të bëjë kompensimin e dy pagave bazë në emër të shpërblimit jubilar për punonjësit e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar i Kosovës në Prishtinë megjithëse paraqet dokument përmbartimor, i njëjti, konform nenit 27 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, nuk është i përshtatshëm për përmbartim.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të ligjshëm, prandaj përfundimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm,

për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale gjithashtu është zbatuar drejtë, e të cilat shkaqe ankimore Gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e përkrah qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e cila me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, ngase nga provat në shkresat e lëndës ka gjetur se dokumenti përmbartimor nuk i plotëson kushtet ligjore për përmbartim, konform dispozitave ligjore në fuqi. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, në rastin konkret dokumenti përmbartimor është i papërshtatshëm për përmbartim edhe nga fakti se me nenin 27 të LPP, në mënyrë shprehimore është përcaktuar se *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Në bazë të nenit të sipërcituar rrjedh se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbartimor të papërshtatshëm për përmbartim. Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se dokumenti përmbartimor-vendimi administrativ i Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1715/94 , të datës 10.02.2020, në dispozitiv të tij nuk e përmban shumën e detyrimit, për çka nuk kuptohet se si do të ekzekutohet një vendim i tillë. Në këtë drejtim Gjykata e Apelit gjen se qëndrojnë arsyetimet e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me papërshtatshmërinë e përmbartueshmërisë së dokumentit përmbartimor në formën dhe përmbajtjen e tij aktuale andaj Gjykata e Apelit si gjykatë ankimore vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur e ka refuzuar propozimin përmbartimor si të pa bazuar.

Po ashtu, Gjykata e Apelit vlerëson se Gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me asnjë nga pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore dhe se gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe Gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1, pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1632/2023 të dt. 27.05.2024

Gjyqtarja
Halide Reka